



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.172

13 nëntor

2008

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.1402, datë 22.10.2008	Për miratimin e rregullave të zhvillimit të ankandit publik, për shitjen e paketës së aksioneve “Albanian Mobile Communications” sh.a., që ka mbetur pas transferimit të paketës tek investitorët strategjikë, tek ish-pronarët e truallit dhe te punonjësit e kësaj shoqërie	8421
Vendim i KM nr.1430, datë 29.10.2008	Për miratimin e raportit të vlerësimit të ofertave për privatizimin e shoqërisë anonime “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes”	8432
Vendim i KM nr.1434, datë 29.10.2008	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i Qendrës së re Kombëtare Dispeçer, i zyrave të reja të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. dhe i dispeçerisë qendrore, Kashar	8435
Vendim i KM nr.1436, datë 31.10.2008	Për një ndryshim në vendimin nr.775, datë 14.11.2007 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Skavicë”, në lumin Drin i Zi, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë”..	8436
Vendim i KM nr.1440, datë 29.10.2008	Për lejimin e kalimit transit të disa autokolonave dhe trupave ushtarake italiane, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë	8437
Vendim i KM nr.1443, datë 31.10.2008	Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), si agjencia e pagesave.....	8438

Vendim i KM nr.1444, datë 22.10.2008	Për mënyrën e funksionimit e të pagesës së anëtarëve të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit, si dhe përcaktimin e procedurave të vlerësimit të shkeljeve	8439
Vendim i KM nr.1449, datë 5.11.2008	Për lejimin e kalimit transit të tri autokolonave ushtarake italiane, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë	8442
Vendim i KM nr.1450, datë 5.11.2008	Për një ndryshim në vendimin nr.901, datë 19.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, nëpunësve të kabineteve dhe punonjësve mbështetës, në administratën e disa institucioneve të pavarura”, të ndryshuar	8443
Vendim i KM nr.1451, datë 5.11.2008	Për disa shtesa në vendimin nr.478, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të disa institucioneve, në varësi të ministrave të linjës”, të ndryshuar	8443
Vendim i KM nr.1452, datë 5.11.2008	Për përcaktimin e pagave të anëtarëve të këshillit drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare	8445
Vendim i KM nr.1453, datë 5.11.2008	Për shpërblimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale, si dhe për përcaktimin e sipërfaqeve takuese të këtyre pasurive	8445
Vendim i KM nr.1455, datë 5.11.2008	Për shtyrjen e afatit të botimit të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur, për procedurat e prokurimit, të kryera nga bashkitë Has e Peshkopi dhe komuna Kolsh, Lezhë, si autoritete kontraktore	8449
Vendim i KM nr.1456, datë 11.11.2008	Për shtyrjen e afatit të botimit të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur, për procedurat e prokurimit, të kryera nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare si autoritet kontraktor	8449
Vendim i KM nr.1457, datë 10.10.2008	Për një shtesë në vendimin nr.153, datë 7.4.2000 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar	8450
Vendim i KM nr.1458, datë 5.11.2008	për shtyrjen e afatit të botimit të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur, për procedurat e prokurimit, të kryera nga Ministria e Brendshme, institucionet në varësi dhe njësitë e qeverisjes vendore, si autoritete kontraktore...	8452
Vendim i KM nr.1459, datë 5.11.2008	Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.....	8462
Vendim i KM nr.1461, datë 5.11.2008	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, për mbulimin e kostos vendore të TVSH-së dhe taksës doganore, në kuadër të projektit “Shpërndarja e shërbimeve sociale në komunitet”, financuar nga IDA.....	8463

Vendim i KM nr.1462, datë 5.11.2008	Për shtyrjen e afatit të botimit të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur për procedurat e prokurimit, të kryera nga Biblioteka Kombëtare, Muzeu Historik Kombëtar, bashkia Elbasan dhe Zyra Shqiptare për të Drjetat e Autorit, si autoritete kontraktore	8464
Vendim i KM nr.1464, datë 5.11.2008	Për shtyrjen e afatit të botimit të njoftimit të kontratës së lidhur, për procedurat e prokurimit, të kryera nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, si autoritet kontraktor	8466
Vendim i KM nr.1470, datë 5.11.2008	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Tepelenë, të qarkut të Gjirokastrës.....	8469
Udhëzim i KM nr.2, datë 5.11.2008	Për disa ndryshime në udhëzimin nr.1, datë 20.8.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2008”	8470
Udhëzim i KM nr.1/2, datë 22.9.2008	Për disa ndryshime në udhëzimin 1/1, datë 13.2.2008 të Ministrisë Bujqesisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministrisë së Financave “Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.10, datë 4.1.2008, “Për mbështetjen e prodhimit bujqësor””	8470
Kërkesë e MPPTT nr.7245/1, datë 6.11.2008	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Kardhiq-Delvinë.....	8472

VENDIM
Nr.1402, datë 22.10.2008

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË ZHVILLIMIT TË ANKANDIT PUBLIK, PËR SHITJEN E PAKETËS SË AKSIONEVE TË “ALBANIAN MOBILE COMMUNICATIONS” SHA, QË KA MBETUR PAS TRANSFERIMIT TË PAKETËS TEK INVESTITORËT STRATEGJIKË, TEK ISH-PRONARËT E TRUALLIT DHE TE PUNONJËSIT E KËSAJ SHOQËRIE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, të neneve 2, 3, pika 3, e 6, të ligjit nr.8515, datë 21.7.1999 “Për privatizimin e shoqërisë anonime “Albanian Mobile Communications” (AMC)” dhe të neneve 17, 19 e 45 të ligjit nr.9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shitja e paketës së aksioneve të AMC sh.a., zotëruar nga shteti shqiptar, e barabartë me 12.5792% të kapitalit të kësaj shoqërie, do të kryhet nëpërmjet ankandit publik, përmes procedurës me përzgjedhje të blerësve, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”.

2. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik” të krijojë, brenda strukturës së vet, njësinë *ad-hoc* të ankandit, e cila do të ketë detyrat e përgjegjësitë e mëposhtme:

i) Përgatitjen e dokumenteve të ankandit dhe paraqitjen e tyre për miratim te Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;

ii) Përcaktimin e kriterëve të vlerësimit për shitjen e paketës së aksioneve, të barabartë me 12.5792% të kapitalit të AMC sh.a.

iii) Caktimin e çmimit të shitjes për paketën e aksioneve, të përcaktuara në nënndarjen ii të kësaj pike, bazuar në vlerën aktuale monetare (VAM), në çmimet e tregut, të dhënat e INSTAT-it apo të organeve të tjera shtetërore, si dhe në përcaktimet e konsulentit ndërkombëtar, të ngarkuara nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës sipas vendimit nr.410, datë 11.7.2007 të Këshillit të Ministrave;

iv) Raportimi pranë Agjencisë së Prokurimit Publik për zhvillimin e ankandit, sipas shtojcës nr.6, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Ngarkohet Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për ngritjen e një komisioni të posaçëm, për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të këtij ankandi publik, si dhe për ndjekjen e procedurave për zhvillimin e tij. Komisioni që do të përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, do ta ushtrojë veprimtarinë në përputhje me rregullat e miratuara për këtë qëllim nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

4. Dokumentet e ankandit publik do të përgatiten nga njësia e ankandit, ngritur sipas pikës 2 të këtij vendimi, dhe do të miratohen me urdhër të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në përputhje me modelet e përcaktuara në shtojcat, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

5. Dokumentet standarde të ankandit përbëhen nga:

i) Formulari i njoftimit;

ii) Kërkesa për pjesëmarrje;

iii) Formulari i ofertës;

iv) Ftesa për ofertë;

v) Formulari i njoftimit të fituesit;

vi) Formulari i publikimit të njoftimit të fituesit;

vii) Procesverbal/et i/e komisionit të vlerësimit të ofertave, sipas modelit të shtojcave, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës miraton dokumentet e mëposhtme dhe dokumente të tjera të nevojshme për zhvillimin e procedurës së ankandit:

- i) procedurat e ankandit;
- ii) dokument/e informuese për AMC sh.a.;
- iii) marrëveshja e konfidencialitetit;
- iv) formulari i sigurimit të ofertës;
- v) autorizimi (prokura) për personat, që veprojnë, në emër e për llogari të ofertuesve;
- vi) marrëveshja për shitjen e aksioneve të AMC sh.a., sipas modelit të miratuar nga kjo ministri.

6. Njoftimi i ankandit publik publikohet nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, dhe përmban, krahas kërkesave të përcaktuara në nenin 24 të ligjit, edhe, të paktën:

- i) një përshkrim të objektit të ankandit;
- ii) treguesin e kriterëve përzgjedhëse të ofertuesve;
- iii) ftesën drejtuar kandidatëve blerës, për të shprehur interesin për pjesëmarrje në procedurën e ankandit me përzgjedhje të blerësve.

7. Njoftimi i ankandit publik, sipas këtij vendimi, i cili bëhet nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, dërgohet për botim në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në të paktën në një gazetë të huaj, me shpërndarje në Europë. Njoftimi i ankandit përmban informacion të përgjithshëm për ankandin publik, me procedurë përzgjedhëse, si dhe kushtet e mënyrën e paraqitjes së kërkesës së kandidatëve blerës për pjesëmarrje.

8. Kërkesat për pjesëmarrje në ankandin publik duhet të paraqiten nga kandidatët blerës pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, brenda afateve të përcaktuara nga dokumentet e ankandit. Afati i dorëzimit të kërkesës për pjesëmarrje nuk mund të jetë më pak se 10 ditë nga data e botimit të njoftimit të ankandit publik, të përcaktuar në pikën 7 të këtij vendimi. Kandidatët blerës paraqesin, së bashku me kërkesën për pjesëmarrje, edhe dokumentet e informacionet e kërkuara nga dokumentet e ankandit.

9. Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatët blerës në kopje fizike, me postë ose dorazi, në vendin e përcaktuar në dokumentet e ankandit.

10. Kandidatët blerës, që dorëzojnë dokumente të rreme ose të falsifikuara, skualifikohen nga ankandi publik për shitjen e paketës së aksioneve të AMC sh.a.

11. Kandidatët blerës përzgjidhen (kandidatët e përzgjedhur) nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në bazë të kriterëve të mëposhtme:

- a) të kapaciteteve financiare për blerjen e paketës së aksioneve të kapitalit të AMC sh.a., objekt i shitjes me ankand publik, sipas këtij vendimi;
- b) të aftësisë për ta përfunduar transaksionin në mënyrën dhe kohën e kërkuar nga dokumentet e ankandit.

12. Pas përfundimit të afatit të dorëzimit të kërkesës për pjesëmarrje, përcaktuar në dokumentet e ankandit, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, nëpërmjet një komunikimi me shkrim, drejtuar njëkohësisht të gjithë kandidatëve të përzgjedhur, fton dorëzimin e ofertave për blerjen e paketës së aksioneve të AMC sh.a., dhe dokumentet e tjera, në vendin dhe orën e përcaktuar në dokumentet e ankandit.

13. Ftesa për kandidatët e përzgjedhur bëhet sipas formës së parashikuar në shtojcat, që i bashkëlidhen këtij vendimi. Ftesa përmban edhe:

- a) kopje të dokumenteve të ankandit publik;
- b) referencë, për të pasur akses në dokumentet e ankandit në rrugë elektronike.

14. Vlera fillestare e shitjes përcaktohet nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, sipas dispozitave të ligjit nr.9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik” dhe dispozitave të këtij vendimi.

15. Vlera fillestare e shitjes u njoftohet, nëpërmjet një komunikimi të njëkohshëm, me shkrim, të gjithë kandidatëve të përzgjedhur në ftesën për ofertë, pas përfundimit të procedurës së përzgjedhjes. Vlera fillestare e shitjes mbahet konfidenciale deri në datën e ftesës për ofertë.

16. Vlera e sigurimit të ofertës përcaktohet nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, sipas dispozitave të ligjit nr.9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik” dhe dispozitave të këtij vendimi.

17. Sigurimi i ofertës bëhet nëpërmjet një garancie bankare. Vlera e sigurimit të ofertës do të

jetë në përqindje të vlerës fillestare të shitjes, përcaktuar në pikën 14 të këtij vendimi.

18. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës përcakton, në dokumentet e ankandit, kërkesat për natyrën, formën, vlerën dhe kushtet e tjera thelbësore të sigurimit të ofertës.

19. Vlera e sigurimit të ofertës u njoftohet kandidatëve të përzgjedhur në ftesën për ofertë pas përfundimit të procedurës së përzgjedhjes. Vlera e sigurimit të ofertës mbahet konfidenciale deri në datën e ftesës për ofertë.

20. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës ka të drejtën të konfiskojë vlerën e sigurimit të ofertës në rastet e parashikuara nga ligji nr.9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”.

21. Ofertat paraqiten nga kandidatët e përzgjedhur në përputhje me afatet e kushtet e përcaktuara në dokumentet e ankandit. Afati i paraqitjes së ofertës nuk mund të jetë më pak se 10 ditë nga data e ftesës për ofertë, njoftuar njëkohësisht nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të gjithë kandidatëve të përzgjedhur.

22. Vendimi për shtyrjen e afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave dhe të dokumenteve të tjera u njoftohet menjëherë dhe njëkohësisht të gjithë kandidatëve të përzgjedhur.

23. Ofertat dorëzohen me shkrim, dorazi ose përmes postës. Dokumentet e ankandit përcaktojnë mënyrat, kushtet, afatet dhe dokumentet, që duhen paraqitur nga kandidatët e përzgjedhur, së bashku me ofertën.

24. Janë të vlefshme dhe të pranueshme nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës ofertat, që përmbajnë gabime shtypi ose gabime të tjera të dukshme, të këtij lloji, që nuk janë bërë qëllimisht dhe rezultojnë qartë nga dokumentacioni tjetër i ankandit, i depozituar nga kandidati i përzgjedhur e që nuk cenojnë vlefshmërinë e ofertës, në përputhje me ligjin.

25. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me ligjin nr.9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, dispozitat e këtij vendimi dhe me procedurat e kriteret e përcaktuara në dokumentet e ankandit.

26. Njoftimi i fituesit dhe lidhja e kontratës kryhen në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”.

27. Kandidatët blerës përballojnë të gjitha shpenzimet e kostot për pjesëmarrjen e tyre në këtë ankand publik me procedurë përzgjedhëse të blerësve.

28. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SHTOJCA 1 NJOFTIMI I ANKANDIT

Data: _____

Autoriteti: _____

Objekti i shitjes: _____

Përshkrim i shkurtër i objektit të shitjes dhe procedurave të ankandit

Vendi: _____

Adresa: _____

Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: _____

Mënyra dhe kushtet e dorëzimit të kërkesave për pjesëmarrje:

Gjuha/ët e kërkesave për pjesëmarrje: shqip ose anglisht

Informacioni mbi dokumentet e ankandit: _____

SHTOJCA 2
KËRKESA PËR PJESEMARRJE

Data: _____

Vendi: _____

I/e/të nënshkruarit _____, kërkojmë të marrim pjesë në fazën përzgjedhëse të procedurave të ankandit për shitjen e 102.374 aksioneve, të barabarta me 12.5792% të kapitalit të “Albanian Mobile Communications” sh.a. (AMC). Mbështetur në kërkesat e dokumenteve të ankandit,

bashkëngjitur gjeni dokumentet që shoqërojnë këtë kërkesë për pjesëmarrje sipas kërkesave të dokumenteve të ankandit:

Për çdo komunikim të nevojshëm, ju lutemi bëni referim në adresat e mëposhtme:

Adresa: _____

E-mail: _____

Fax: _____

Tel: _____

(nënshkrimi/vula)

SHTOJCA 3 FTESA PËR OFERTË

Autoriteti: _____

Data: _____

Vendi: _____

Njoftohet _____, se në vijim të njoftimit të ankandit publik botuar në _____, kërkesa për pjesëmarrje në fazën përzgjedhëse të procedurave të ankandit për shitjen e 102.374 aksioneve të barabarta me 12.5792% të kapitalit të “Albania Mobile

Communications” sh.a. (AMC) e paraqitur më datë _____ së bashku me dokumentet e tjera të kërkuara nga dokumentet e ankandit është vlerësuar se përmbush kriteret e kërkuara.

Ju njoftojmë se jeni përzgjedhur për të marrë pjesë në ankandin si më sipër dhe ju ftojmë të paraqisni ofertat tuaja, së bashku me dokumentacionin e kërkuar sipas dokumenteve të ankandit. Afati i fundit për dorëzimin e ofertave dhe dokumentacionit të kërkuar është data ____ora____ në adresën_____.

Bashkëngjitur do të gjeni:

- kopje të dokumenteve të ankandit publik dhe dokumenteve të tjera mbështetëse;
- referencë për të pasur akses në dokumentet e ankandit në rrugë elektronike.

Vlera fillestare e shitjes së 102.374 aksioneve, të barabarta me 12.5792% të kapitali të “Albanian Mobile Communications” sh.a. (AMC) është caktuar:

_____euro

Ofertat me vlerë më të ulët nuk do të pranohen.

Vlera e sigurimit të ofertës duhet të jetë _____% të vlerës fillestare të shitjes si më sipër.

Oferta dhe dokumentet e tjera të kërkuara duhet të jenë në gjuhën shqipe ose angleze.

(nënshkrimi i përfaqësuesit të autoritetit shitës/vula)

SHTOJCA 4 FORMULARI I OFERTËS

Drejtuar: Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

Lënda: Shitja e paketës së aksioneve, të barabartë me 12.5792% të kapitalit të shoqërisë “Albania Mobile Communications” sh.a.

Të nderuar zotërinj!

Pas shqyrtimit të dokumenteve të ankandit që na janë dorëzuar dhe pranuar nga ne, i/e/të nënshkruarit _____ ofrojmë të blejmë 102.374 aksione, të barabarta me 12.5792% të kapitalit të “Albanian Mobile Communications” sh.a. (AMC), me çmimin

prej _____ eurosh¹ (përshkrim me fjalë).

Autorizojmë METE-n të verifikojë informacionin/dokumentet, bashkëngjitur ofertës sonë.

Oferta do të jetë e vlefshme për një periudhë prej _____ duke filluar nga _____, dhe mund të pranohet nga ju në çdo moment përpara përfundimit të kësaj periudhe. Në rast se shpallemi si ofertuesi fitues, pranojmë në mënyrë të parevokueshme të lidhim marrëveshjen për blerjen e aksioneve me METE-n, sipas formës së përcaktuar në dokumentet e ankandit.

Pranojmë se në rast mospërputhjeje të parashikimeve të kësaj oferte me kushtet dhe afatet e dokumenteve të ankandit, kjo ofertë nuk do të konsiderohet e vlefshme.

Pranojmë se METE në çdo kohë mund të anulojë ankandin, në çdo kohë deri në momentin e njoftimit të fituesit, dhe METE nuk mban përgjegjësi ndaj nesh për ofertën e paraqitur.

Të gjitha shpenzimet, kostot e humbjet lidhur me përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës do të përballohen nga ne. METE nuk do të kompensojë kosto, shpenzime apo humbje, pavarësisht rezultatit të përfundimit të ankandit. Pranojmë gjithashtu në mënyrë të parevokueshme të paguajmë kostot e botimit të ankandit në rast se do të shpallemi fitues të ankandit.

Data _____

ëvula, nënshkrimi]

SHTOJCA 5 NJOFTIMI I FITUESIT

Autoriteti: _____

Data: _____

Vendi: _____

Njoftohet _____, se oferta e paraqitur më datë _____ me të dhënat e mëposhtme:

Është shqyrtuar e vlerësuar nga komisioni i vlerësimit të ofertave të ankandit publik si oferta fituese për blerjen e 102.374 aksioneve, të barabarta me 12.5792% të kapitalit të “Albania Mobile

¹ Jo më pak se vlera fillestare.

Comumunications” sh.a. (AMC).

Ftohet _____ të nënshkruajë marrëveshjen për blerjen e aksioneve si më sipër sipas formatit të dokumenteve të ankandit brenda 10 ditëve nga publikimi në Buletinin e Njoftimeve Publike, në përputhje me kushtet e afatet e dokumenteve të ankandit.

(nënshkrimi i përfaqësuesit të autoritetit shitës/vula)

SHTOJCA 6
FORMULARI I PUBLIKIMIT TË NJOFTIMIT TË OFERTUESIT FITUES

Seksioni I: Autoriteti kontraktues

I.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktues

Emri

Adresa

Internet:

I.2 Lloji i autoritetit kontraktues dhe aktiviteti ose aktivitetet kryesore:

Institucioni qendror	Institucioni i pavarur
☐	☐

Njësia e qeverisjes vendore	Tjetër
☐	☐

Seksioni II: Objekti i ankandit

II.1 Lloji i kontratës

II.2 Përshkrim i shkurtër i kontratës

Objekti i kontratës:

Të tjera:

Seksioni III: Procedura

Lloji i procedurës:

III.1 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit (ofertuesit)

III.2 Numri i ofertave të dorëzuara:

Numri i ofertave të vlefshme:

III.3 Referenca e dosjes, e përcaktuar sipas autoritetit kontraktues:

IV.3 Vlera totale përfundimtare e kontratës:

Vlera	_____	M onedha	_____

IV.4 Publikime të mëparshme, lidhur me të njëjtën kontratë (nëse zbatohet):

Buletini i Njoftimeve Publike	Data	_____	Numri	_____
Gazeta _____				

Ofertuesit në ankand

Emri	Adresa	Përfaqësuesi	I kualifikuar(po/jo)

Ofertuesit e kualifikuar

Emri	Adresa	Përfaqësuesi	Vlera e ofertës
------	--------	--------------	-----------------

Ofertuesit e skualifikuar

Emri	Adresa	Përfaqësuesi	Arsyet e skualifikimit

Ofertuesi fitues

Emri	Adresa	Përfaqësuesi	Vlera e ofertës

V.4 Informacione shtesë

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi _____

SHTOJCA 7 PROCESVERBAL I KOMISIONIT TË VLERËSIMIT TË OFERTËS

Datë: _____

Vendi: _____

Ora: _____

Nr.prot. _____

U mbajt mbledhja e komisionit të vlerësimit të ofertave të ankandit me rend dite _____.

Të pranishëm:

Përshkrimi i procedurave të ndjekura dhe i vendimeve të marra.

Në vijim, komisioni i vlerësimit të ofertave me votën pro të _____ anëtarëve dhe votën kundër të _____ anëtarëve vendosi:

Kryetari

Sekretari

(nënshkrimi)

(nënshkrimi)

VENDIM
Nr.1430, datë 29.10.2008

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË VLERËSIMIT TË OFERTAVE PËR PRIVATIZIMIN E SHOQËRISË ANONIME “OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit nr.9889, datë 20.3.2008 “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” dhe në vijim të vendimit nr.835, datë 11.6.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e madhësisë së paketës së aksioneve të kapitalit, të shoqërisë anonime “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes”, që u ofrohet investitorëve strategjikë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e raportit të vlerësimit të ofertave, për privatizimin e 76 për qind të aksioneve të shoqërisë anonime “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes”, të përgatitur nga komisioni i vlerësimit të ofertave.
2. Shpalljen fitues të tenderit për privatizimin e shoqërisë anonime “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” shoqërinë çeke CEZ, a.s. si ofertuesi i preferuar, në bazë të çmimit të ofruar për blerjen e 76 për qind të aksioneve.
3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të fillojë negociimet dhe të nënshkruajë marrëveshjen me ofertuesin fitues, shoqërinë çeke CEZ a.s.
4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE TË PRIVATIZIMIT TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SHA

RAPORTI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE

METE nisi procedurën për shitjen e 76% të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a. në 13 maj 2008 me shpalljen e tenderit të privatizimit. Procesi u organizua në dy faza:

1. Faza parakualifikuese, prej së cilës katër kompani u shpallën si të parakualifikuar:

- a) kompania çeke CEZ;
- b) kompania italiane “Enel”;
- c) kompania austriake “Etag”;
- d) kompania austriake EVN.

2. Faza e tenderimit. Pas ftesës për ofertë dërguar katër kompanive të parakualifikuara, ditën e hënë, datë 29 shtator 2008. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës mori dy oferta, të cilat u dorëzuan pranë kësaj ministrie para orës 14.00, siç ishte parashikuar në dokumentet standarde të tenderit.

1. Ofertuesit

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në procesin e privatizimit të OSSH sh.a. mori 2 oferta prej:

- ENEL një kompani e regjistruar në Itali sipas legjislacionit italian;
- CEZ një kompani e regjistruar në Çeki sipas legjislacionit të Republikës Çeke.

2. Procedurat e vlerësimit të ofertave

Në përputhje me udhëzimet për ofertuesit, të hënën në datë 29.9.2008, komisioni i vlerësimit të ofertave hapi në publik zarfet e jashtme të ofertave, si dhe zarfet e ofertës teknike. Në praninë e kompanive ofertuese, si dhe të mediave, komisioni shpalli emrat e ofertuesve, si dhe prezencën e “garancisë së ofertës” dhe “deklaratës së konfirmimit të pranimin të kushteve minimale të performancës teknike”. Pas kësaj komisioni u tërhoq për të filluar procedurën e vlerësimit teknik të ofertave.

Përfaqësues të IFC-së (International Finance Corporation) pjesë e Grupit të Bankës Botërore morën pjesë gjatë të gjithë procesit të vlerësimit të ofertave në rolin e tyre si konsulentë të Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës në transaksionin e privatizimit të OSSH-së. Një prej këtyre përfaqësuesve ishte në rolin e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, por pa të drejtë vote.

Oferta teknike

Komisioni i vlerësimit të ofertave filloi të shqyrtojë secilën prej ofertave teknike për të përcaktuar nëse ato ishin të plota dhe në përputhje me kërkesat e paraqitura në dokumentet standarde të tenderit.

Së pari, komisioni bëri një shqyrtim të ofertave teknike lidhur me kushtet e përgjithshme të përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit si më poshtë:

1. Gjuha e dokumenteve të ofertës teknike të ishte ajo angleze.

2. Të gjitha dokumentet e ofertës teknike të ishin të firmosura nga personi ose personat e autorizuar, si dhe të gjitha fletët e ofertës teknike të mbanin inicialet e personit apo personave të autorizuar.

3. Nëse në brendësi të dokumentacionit të dorëzuar kishte korrigjime apo komente dhe nëse po qe këto të ishin të firmosura nga personi apo personat e autorizuar.

4. Që oferta teknike përmbante të gjitha dokumentet e kërkuara në “Udhëzimet për ofertuesit”.

A.KVO konstatoi se oferta teknike e kompanisë italiane “Enel” kishte parregullsitë si më poshtë:

a) Mungonte “Plani i biznesit”, i kërkuar në pikën (viii) të paragrafit 3.1.1 të seksionit 3.1 Përgatitja e ofertave të “Udhëzimeve për ofertuesit”;

b) Mungonte drafti i marrëveshjes për blerjen e aksioneve me komentet e kufizuara, i kërkuar nga seksioni 5.2 (i) “Udhëzimeve për ofertuesit”.

B. KVO konstatoi se oferta teknike e kompanisë çeke CEZ nuk kishte asnjë parregullsi në lidhje me shqyrtimin e përshkruar më sipër.

Së dyti, KVO shqyrtoi me imtësi përputhshmërinë e dokumenteve të të dyja ofertave teknike me kërkesat e përcaktuara në “Udhëzimet për ofertuesit” në lidhje me përmbajtjen e:

1. formës së aplikimit në tender, e cila duhet t’i përmbahet aneksit 15 në “Udhëzimet për ofertuesit”;

2. prokurës, e cila duhet të jetë e firmosur dhe e noterizuar dhe të përcaktojë qartë personin e autorizuar;

3. deklaratës së konfliktit të interesit, ku konflikti i interesit të përkufizohet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi;

4. deklaratës së komisioneve dhe shpërblimeve;

5. planit të biznesit, i cili duhet të mbulojë çështjet e përcaktuara në aneksin 13 në “Udhëzimet për ofertuesit”;

6. Garancisë së ofertës, e cila duhet t’i përmbahet tekstit në aneksin 10 në “Udhëzimet për ofertuesit”, duhet të jetë e nënshkruar nga një bankë e regjistruar në Shqipëri dhe të jetë në shumën e pesë milionë eurove;

7. Formës së konfirmimit të kushteve të detyrueshme minimale të performancës teknike, e cila duhet të jetë në përputhje me aneksin 17 të “Udhëzimeve për ofertuesit”;

8. Draftit përfundimtar të marrëveshjes së blerjes së aksioneve dhe deklaratës rregullat, bashkëngjitur me komentet nga ofertuesit. Drafti me komentet e kufizuara duhet të përfshijë komente vetëm në fushat si më poshtë:

- Garancia e detyrimeve në lidhje me titullin (aktiveve dhe aksioneve) dhe detyrimet;

- Garancia e detyrimeve në lidhje me paraqitjen e plotë e të gjithë të informacionit të rëndësishëm;

- Kushtet përpara mbylljes vetëm referuar aprovimit të kreditorëve të borxheve afatgjata dhe PRG (aprovimi i Komitetit të Veprimeve të BB);

- Mekanizmi i rregullimit të çmimit vetëm referuar kufizimit të rregullimit të çmimit të blerjes;

- Niveli i lejuar i borxhit të keq;

- Teprica e fitimit për furnizuesin me pakicë;

- Mekanizmi i kompensimit për të ardhurat e panjohura në tarifat e shitjes;

- Niveli i të ardhurave nga kapitali (*return on equity*);

- Niveli fillestar i humbjeve të shpërndarjes të njohura në tarifat e shitjes, por jo në programin e reduktimit të humbjeve;

- Kalim i plotë i kostove të arsyeshme të blerjes së energjisë për humbjet e aprovuara.

Sipas shqyrtimit të përmbajtjes së ofertave teknike dhe në bazë të kërkesave të përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit, KVO konstatoi se:

A. KVO konstatoi se oferta teknike e dorëzuar nga kompania italiane “Enel” kishte parregullsitë e mëposhtme:

a) Teksti i formës së aplikimit në tender nuk i përmbahet aneksit 15 të “Udhëzimeve për ofertuesit”;

b) Forma e konfirmimit të kushteve minimale të detyrueshme të performancës teknike, dorëzuar nga shoqëria italiane “Enel” SpA, nuk është në përputhje me aneksin 17 të “Udhëzimeve për ofertuesit”.

B. KVO konstatoi se oferta teknike e kompanisë çeke CEZ nuk kishte asnjë parregullsi në lidhje me shqyrtimin e përshkruar më sipër.

Duke pasur parasysh vërejtjet dhe konstatimet e sipërpërmendura, KVO vendosi që:

1. Oferta teknike e dorëzuar nga kompania italiane Enel nuk është e plotë dhe nuk përputhet me “Udhëzimet për ofertuesit”. Për pasojë, oferta teknike e dorëzuar nga “Enel” nuk e kalon vlerësimin teknik.

2. Oferta teknike e dorëzuar nga kompania çeke CEZ është e plotë dhe në përputhje me kërkesat e “Udhëzimeve për ofertuesit”. Për pasojë, oferta teknike e dorëzuar nga CEZ e kalon vlerësimin teknik.

Ofertat financiare

Në përputhje me seksionin 5.3.1 të “Udhëzimeve për ofertuesit”, KVO hapi zarfet e ofertës financiare të vetëm atyre ofertuesve, të cilët kaluan vlerësimin e ofertave teknike.

Meqenëse oferta teknike e kompanisë italiane Enel nuk e kaloi vlerësimin teknik, KVO nuk e hapi zarfin e kompanisë “Enel”, por vetëm atë të CEZ-it, pasi oferta teknike e CEZ-it ishte e vetmja që kaloi vlerësimin teknik.

Hapja e zarfit me ofertën financiare të CEZ-it u krye në prani të përfaqësuesve të kompanive ofertuese, si dhe të mediave.

Çmimi i ofruar për blerjen e 76% të aksioneve të OSSH-së është: 102 milionë euro.

Renditja e ofertuesve

Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas shqyrtimit të ofertës së vetme financiare, vendosi që kompania CEZ, s.a. të renditet e para.

Rekomandimet

Për sa më sipër, komisioni i vlerësimit të ofertave i rekomandon Këshillit të Ministrave:

1. Të miratojë këtë raport të vlerësimit të ofertave të përgatitur nga komisioni i vlerësimit të ofertave.

2. Të shpallë fitues të tenderit të privatizimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes kompaninë çeke CEZ si ofertuesin e preferuar në bazë të çmimit të ofruar për blerjen e 76% të aksioneve.

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE

KRYETARI

Neritan Alibali

VENDIM

Nr.1434, datë 29.10.2008

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I QENDRËS SË RE KOMBËTARE DISPEÇER, I ZYRAVE TË REJA TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT (OST) SHA DHE I DISPEÇERISË QENDRORE, KASHAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i Qendrës së re Kombëtare Dispeçer, i zyrave të reja të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., Tiranë dhe Dispeçerisë Qendrore, në Kashar, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të OST sh.a.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 20 935 (njëzet mijë e nëntëqind e tridhjetë e pesë) m², tokë bujqësore/arë, vlerësuar në shumën e përgjithshme 52 487 020 (pesëdhjetë e dy milionë e katërqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e njëzet) lekë.

4. Fondi prej 52 487 020 (pesëdhjetë e dy milionë e katërqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e njëzet) lekësh të përballohet nga fondet e OST sh.a., zëri “Kosto vendore për shpronësimet”.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të shpronësimit, në shumën 165 000 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë, të përballohet nga OST sha-ja, si subjekti kërkues i këtij shpronësimi.

6. Shpronësimi të fillojë brenda muajit shtator dhe të përfundojë brenda muajit dhjetor 2008.

7. Mënyra e pagesës të bëhet pas paraqitjes së dokumenteve të pronësisë, sipas ligjit nr.8561,

datë 22.12.1999.

8. Punimet për ndërtimin e Qendrës së re Kombëtare Dispeçer, të zyrave të reja të OST sh.a., Tiranë dhe të Dispeçerisë Qendrore, në Kashar, të përfundojnë brenda muajit dhjetor 2009.

9. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe OST sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË “NDËRTIM TË QENDRËS SË RE
KOMBËTARE DISPEÇER DHE ZYRAT E REJA TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË
TRANSMETIMIT DHE DISPEÇERISË QENDRORE, KASHAR”

Rrethi: Tiranë
Komuna: Kashar

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: arë

SHPRONËSIMI DEFINITIV											
Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Nr. kadastral	Nr. pasurisë	Sip.e shpron. në m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera e kulturës bujq.	Vlera në lekë	Adresa
1	Isuf	Adem	Sula	Arë	2105	1/16	6060	2500	42420	15192420	Kashar, Tiranë
2	Jemin	Adem	Sula	Arë	2105	1/17	14875	2500	107100	37294600	Kashar, Tiranë
Shuma							20 935			52487020	

Shpenzimet procedurale konsistojnë në:

1. Publikimi në 2 gazeta me shpërndarje kombëtare “Koha Jonë” dhe “Standard”, për një periudhë njëjavore për çdo publikim, të cilat kapin vlerën 140 000 (njëqind e dyzet mijë) lekë.

2. Bazuar në pikën 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.126, datë 23.3.2000 “Për përbërjen dhe procedurat e punësimit të komisionit, të posaçëm të shpronësimit”, është parashikuar një masë shpërblymje për 5 anëtarët e komisionit në vlerë totale prej 25 000 (njëzetë e pesë mijë) lekësh.

3. Totali i shpenzimeve të kryera nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, por që realisht do të mbulohen nga “OST” sh.a., Tiranë, si subjekt kërkues për këtë shpronësim, janë në

vlerën totale 165 000 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë.

VENDIM
Nr.1436, datë 31.10.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.775, DATË 14.11.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN
ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT “SKAVICË”, NË LUMIN DRIN I ZI, DHE
MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I
JEPET SHOQËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b”, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 2 të vendimit nr.775, datë 14.11.2007 të Këshillit të Ministrave, fjalët “...prej 10 për qind të pikëve...” zëvendësohen me fjalët “...prej 4 për qind të pikëve...”.
 2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1440, datë 29.10.2008

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË DISA AUTOKOLONAVE DHE TRUPAVE
USHTARAKE ITALIANE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Porti i Durrësit-Qafë-Thanë, në datën 30 tetor 2008, të 6 autokolonave ushtarake italiane, të përbëra, si më poshtë vijon:

- Autokolona e parë, me 20 (njëzet) automjete e 42 (dyzet e dy) trupa;
- Autokolona e dytë, me 20 (njëzet) automjete e 47 (dyzet e shtatë) trupa;
- Autokolona e tretë, me 20 (njëzet) automjete e 23 (njëzet e tre) trupa;
- Autokolona e katërt, me 20 (njëzet) automjete e 41 (dyzet e një) trupa;
- Autokolona e pestë, me 20 (njëzet) automjete e 41 (dyzet e një) trupa;
- Autokolona e gjashtë, me 20 (njëzet) automjete e 46 (dyzet e gjashtë) trupa.

2. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë është pika e kalimit të kufirit Porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

3. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në

Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë, për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre”, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

4. Autokolonat ushtarake italiane, gjatë itinerarit të lëvizjes nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

5. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.1443, datë 31.10.2008

PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL (AZHBR), SI AGJENCIA E PAGESAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 21 të ligjit nr.9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, dhe të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), si agjencia e pagesave, në kuptim të nenit 21 të ligjit nr.9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”.

2. AZHBR-ja ka strukturë qendrore dhe struktura vendore, në shkallë qarku.

3. Drejtori i AZHBR-së emërohet, lirohet ose shkarkohet nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. Drejtuesit dhe punonjësit e tjerë të kësaj agjencie, përfshirë edhe ata të strukturave vendore, prانه sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin për shërbimin civil. Numri i punonjësve të agjencisë është 86 veta.

4. AZHBR-ja është përgjegjëse për administrimin e fondeve të programit për bujqësinë dhe për zhvillimin rural, si më poshtë vijon:

a) Fondet e Buxhetit të Shtetit, për mbështetje të drejtpërdrejtë të prodhimit bujqësor;

b) Fondet e Buxhetit të Shtetit, për zhvillimin e infrastrukturës së tregjeve bujqësore;

c) Fondet kundërparti, të projektit 2KR.

Kriteret e përgjithshme të përdorimit të fondeve kundërparti, të projektit 2 KR, përcaktohen me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

5. AZHBR-ja harton planin e veprimit për përafrimin e strukturës organizative dhe të kapaciteteve të saj, menaxhuese dhe teknike, me standardet e akreditimit të BE-së.

6. AZHBR-ja harton dhe propozon projekte, si dhe merr masa për krijimin e administrimit e databazave dhe të logjistikës IT, të nevojshme për funksionimin e saj, sipas standardeve të BE-së.

7. AZHBR-ja do të fillojë të funksionojë më 1 janar 2009.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga Buxheti i Shtetit, miratuar për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

9. Rregullat dhe procedurat e funksionimit të brendshëm të AZHBR-së, si dhe ndarja e detyrave, përgjegjësiave e kompetencave, ndërmjet saj dhe drejtorive rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit (DRBUMK) e aktorëve të tjerë, të sistemit të bujqësisë dhe ushqimit, përcaktohen me udhëzim të veçantë të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

10. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM
Nr.1444, datë 22.10.2008

**PËR MËNYRËN E FUNKSIONIMIT E TË PAGESËS SË ANËTARËVE TË KOMISIONIT
TË MBROJTJES SË KONSUMATORIT, SI DHE PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË
VLERËSIMIT TË SHKELJEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 52 të ligjit nr.9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Objekti i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave për funksionimin e komisionit të mbrojtjes së konsumatorit (më poshtë komisioni), si dhe përcaktimi i procedurave për vlerësimin e shkeljeve të ligjit nr.9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, dhe të akteve nënligjore, dalë në zbatim të tij.

2. Komisioni është organ vendimmarrës.

3. Komisioni ka përgjegjësinë të shqyrtojë shkeljet e ligjit nr.9902, datë 17.4.2008, për:

- a) praktikat e padrejta tregtare;
- b) publicitetin e padrejtë, çorientues dhe krahases;
- c) kushtet e padrejta në kontratat me konsumatorët;
- ç) shitjen e mallrave, të shoqëruar me garanci, dhe përputhshmërinë kontraktuale;
- d) kontratat e lidhura jashtë qendrave të tregimit;
- dh) kontratat në largësi;
- e) shitjen e energjisë, shërbimet e ujit dhe të telekomunikacionit;
- ë) kontratat e përdorimit me afat të pasurive të paluajtshme (*timeshare*);
- f) kreditë e konsumatorëve;
- g) kontratat e paketave të udhëtimit.

4. Komisioni shqyrton dhe vendos nëse kërkesat, ankesat ose dokumentet e tjera, të këtij lloji, të paraqitura në komision, janë objekt i veprimtarisë së tij.

5. Komisioni, kur vë re se kërkesat, ankesat ose dokumentet e tjera, të këtij lloji, nuk janë objekt i veprimtarisë së tij, njofton autoritetin përgjegjës.

6. Komisioni mund të vendosë:

- a) të nxjerrë paralajmërime për ndreqjen e shkeljes;
- b) të japë masa detyruese, për ndreqjen e shkeljes;
- c) të urdhërojë ndalimin e shkeljes ose të vendosë gjobat, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9902, datë 8.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”.

7. Komisioni mund t’i kërkojë strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut verifikimin e shkeljes në treg ose ndonjë informacion tjetër, të nevojshëm për vlerësimin e çështjes dhe marrjen e vendimit.

8. Komisioni mund të kërkojë mendimin e ekspertëve të fushës, në varësi të çështjes.

9. Komisioni ka të drejtë të kërkojë nga tregtarët përkatës të gjitha dokumentet e nevojshme për vlerësimin e plotë të çështjes.

10. Kryetari i komisionit zgjidhet nga anëtarët, ndërmjet dy përfaqësuesve të ministrisë përgjegjëse për fushën e tregtisë (më poshtë ministria).

11. Kryetari i komisionit kryen detyrat e mëposhtme:

- a) drejton mbledhjet;
- b) vendos për rendin e ditës dhe datën e mbledhjes;
- c) nënshkruan vendimet.

12. Komisioni zgjedh, ndërmjet anëtarëve të tij, zëvendëskryetarin, i cili, kur kryetari mungon ose është në pamundësi për të ushtruar funksionet, ushtron kompetencat e këtij të fundit.

13. Kur kryetari dhe nënkryetari i komisionit mungojnë apo janë në pamundësi për të ushtruar funksionet e tyre, mbledhja drejtohet nga anëtari më i vjetër në moshë.

14. Anëtarët e komisionit, sekretariati teknik gjatë mandatit të tyre duhet të ndjekin rregullat e etikës profesionale.

15. Çdo anëtar i komisionit nënshkruan në mbledhjen e parë një deklaratë për paanshmërinë e tij gjatë kohëzgjatjes së mandatit.

16. Çdo anëtar i komisionit ka të drejtën e një vote, pro, kundër ose abstenim.

17. Anëtarët e komisionit kanë të drejtë:

- a) të ngrenë çështje, me interes për punën e komisionit;
- b) të sugjerojnë rendin e ditës për mbledhjet e komisionit.

18. Detyrat e sekretariatit teknik janë:

a) Merr të gjitha masat organizative për përgatitjen e mbledhjeve të komisionit;

b) Kujdeset për përgatitjen e raportit dhe të materialeve të tjera, që duhet t'i paraqiten komisionit për shqyrtim.

c) Bashkërendon punën e komisionit me institucionet e tjera dhe palët e interesuara për çështjet e rendit të ditës së mbledhjes e për përgatitjen në kohë të materialeve.

ç) Mban procesverbalin e mbledhjes.

d) Mban dhe regjistron dokumentacionin e veprimtarive të komisionit.

dh) Lehtëson shkëmbimin e informacionit, ndërmjet palëve të interesuara apo personave të tjerë, rreth çështjeve të diskutuara nga komisioni.

e) Mbështet komisionin, me kërkesën e tij, gjatë procedurave të diskutimit të çështjeve.

19. Datat e mbledhjeve të radhës vendosen nga kryetari dhe u bëhen të ditura anëtarëve të komisionit të paktën 8 ditë pune para datës së mbledhjes.

20. Mbledhjet e jashtëzakonshme të komisionit mund të thirren nga kryetari ose me kërkesë të shumicës së anëtarëve.

21. Mbledhjet e komisionit janë të vlefshme kur janë të paktën 3 anëtarë të komisionit. Kur kjo shumicë nuk është mbledhur, caktohet një datë tjetër brenda tri ditëve pune.

22. Anëtarët e komisionit njoftohen menjëherë për çdo ndryshim të datës apo orës së mbledhjes, si dhe për mbledhjet e jashtëzakonshme.

23. Komisioni i merr vendimet me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm. Në rast barazimi votash, vota e kryetarit është vendimtare.

24. Procesverbalin e mbledhjes nënshkruhet nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës. Votat e anëtarëve regjistrohen në procesverbalin e mbledhjes.

25. Si rregull, mbledhjet e komisionit janë të mbyllura për publikun.

26. Sekretariati teknik merr pjesë në të gjitha mbledhjet e komisionit.

27. Me propozimin e kryetarit ose të paktën të njërit prej anëtarëve, komisioni vendos të ftojë palët e interesuara dhe/ose specialistë të fushës, të marrin pjesë në mbledhje.

28. Me propozimin e kryetarit ose të njërit prej anëtarëve, komisioni mund të vendosë të zhvillojë mbledhjet e hapura për publikun dhe median.

29. Rendi i ditës përgatitet nga sekretariati teknik dhe i dërgohet për shqyrtim komisionit 8 ditë pune përpara datës së mbledhjes. Komisioni ka të drejtë që, brenda 3 ditëve pune, të vendosë për rendin e ditës së mbledhjes.

30. Të gjitha materialet dhe dokumentet e nevojshme për vlerësimin e çështjes u shpërndahen anëtarëve të komisionit të paktën 5 ditë pune përpara datës së mbledhjes. Në raste të veçanta, gjatë mbledhjes mund të shpërndahen materiale shtesë.

31. Komisioni merr vendime vetëm për çështjet e përfshira në rendin e ditës së mbledhjes.

Komisioni shqyrton shkeljen dhe merr vendimin përfundimtar brenda dy muajve nga data e marrjes dijeni për shkeljen.

32. Komisioni mund të organizojë seanca dëgjimore, ku palëve të interesuara u jepet mundësia të paraqesin shpjegimet dhe pretendimet e tyre.

33. Mosmarrja pjesë e palëve të interesuara ose e përfaqësuesve të tyre nuk pezullon a ndalon trajtimin e çështjes.

34. Kërkesat, ankesat dhe materialet e tjera, adresuar komisionit, dhe dokumentacioni përkatës, bashkëlidhur, i dërgohen sekretariatit teknik, në zarf të mbyllur.

35. Kërkesat, ankesat dhe materialet e tjera mblidhen nga sekretariati teknik dhe, pasi regjistrohen, i komunikohen komisionit. Materialet ruhen për 6 muaj dhe më pas kalohen në arkivin e ministrit.

